



17 qershor 2011

## **RAPORT ME REKOMANDIM**

për

*Marrjen e masave të menjëhershme me qëllim të zbatimit nenit 395 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPPK) UNMIK/RREG/2003/26K, përkatësisht të përpilimit dhe dorëzimit të aktgjykimit nga Gjykata Supreme e Kosovës.*

Drejtuar

**Z. Enver Peci, Kryesues i**

**Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

*A. nr. 271/2010*

*Agron Kastrati*

*kundër*

**Gjykatës Supreme të Kosovës**

I nderuari z. Peci,

Përmes kësaj letre dëshiroj ta drejtoj vëmendjen Tuaj në rastin z. Agron Kastrati, i cili është ankuar tek Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore për të vendosur për lëndën e tij, P. Nr.47/2009.

Z. Kastrati me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 3 korrik 2009 është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi në kohëzgjatje prej 7 vite heqje lirie, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, nga 20 korrik 2006. Z. Kastrati është shpallur fajtor për vepër penale të rëndë në ndihmë, por ende nuk ka një vendim përfundimtar, tani e pesë vite, ndërsa kryesi i veprës penale, F.B. ka një vendim të plotfuqishëm, është në vuajtje të dënimit dhe është duke shfrytëzuar beneficionet.

Më 13 tetor 2010, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në takimin që kanë pasur me Ju e kanë ngritur këtë çështje, por këto shqetësime janë përcjellur edhe me shkresën e datës 15 mars 2011, Juve dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme, z. Fejzullah Hasani.



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmanna • Ombudsperson Institution

---

Më 21 mars 2011, unë kam pranuar një shkresë nga z. Hasani me të cilën jam njoftuar se është caktuar data e mbajtjes së seancës, më 31 mars 2011 dhe se lënda ka marrë shenjë Ap.nr.323/2009.

Më 31 mars 2011, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në seancën e mbajtur lidhur me rastin në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe në fund të seancës është kërkuar një kopje e aktgjykimit, por deri më sot ne nuk e kemi marrë nga gjykata, por as pala nuk e ka pranuar aktgjykimin.

Konsiderojmë se lidhur me këtë rast nuk janë respektuar dispozitat ligjore të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPPK) UNMIK/RREG/2003/26, lidhur me afatet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit gjyqësor pas përfundimit të seancës gjyqësore, pasi që nga seanca e mbajtur gjyqësore më 31 mars 2011, nuk është përpiluar aktgjykimi nga gjykata lidhur me rastin, por as nuk është njoftuar Avokati i Popullit.

Ju përkujtojmë se sipas nenit 395, citojë “Aktgjykimi i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në raste të tjera.....Kryetari i gjykatës ndërmerr masat e nevojshme për përpilim sa më të shpejtë të aktgjykimit, por jo më vonë se tridhjetë ditë nga shpallja e tij nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim dhe katërdhjetë e pesë ditë në raste të tjera.”

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura më lart, në pajtim me nenin 132, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 16.1.1; 16.1.2; 16.4; 16. 6; 16.7 dhe neni 23, pika 1 dhe 23. 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195:

### REKOMANDOJMË :

1. Të ndërmerren masa të menjëhershme që Gjykata Supreme e Kosovës të përpilojnë vendimin gjyqësorë lidhur me rastin penal P. Nr.47/2009 të Agron Kastrati në përputhje me nenin 395 të Kodit Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPPK) UNMIK/RREG/2003/26 dhe të kërkohet nga të gjitha gjykatat respektimi i kësaj dispozite ligjore.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës , nën mbikëqyrjen e të cilit janë Gjykatat e Kosovës, ti përkujtojë gjykatat , për obligimin e tyre ligjor për bashkëpunim dhe përgjigjeje në kërkesat e Avokatit të Popullit
3. Një kopje e vendimit të gjykatës lidhur me rastin penal P. Nr.47/2009 të Agron Kastrati ti dërgohet Avokatit të Popullit.



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

Në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.03/L-195 dhe nenin 135 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerreni, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem mirësisht që përgjigjen Tuaj, në lidhje me këtë ta dërgoni brenda një afati ligjor prej tridhjetë (30) ditor.

Me nderime,

Sami Kurteshi  
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës,  
Z. Hajredin Kuçi, Ministër i Drejtësisë,  
Z.Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme,  
Znj. Florentina Beqiraj, koordinatore e Njesisë për të Drejtat e Njeriut, Ministria e  
Drejtësisë.